



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 04

Datë: 11. 04. 2019. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019 (**Kjo pikë, hiqet nga rendi i ditës...**).
 3. Vendim për shpalljen e konkursit për pozitat e lira në Sekretariat të KQZ-së;
 4. “Shqyrtimi dhe miratimi i ushtruesit të detyrës së Drejtorit të ZRPP-së”.
 5. Përbërja e Këshillave të KQZ-së;
 6. Plotësimi dhe Ndryshimi i Vendimit për Zgjatjen e Orarit të Punës;
 7. Të ndryshme.
-

1. **Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

Valdete Daka: Para jush e keni rendin e ditës: A ka dikush ndonjë sugjerim, vërejtje, propozim lidhur me rendin e ditës...?

Adnan Rrustemi: Pika e dytë, mendoj që Plani i Buxhetit së pari duhet të kaloj nëpër këshilla, dhe pastaj ta miratojmë ne..

Valdete Daka: Po, le të kaloj së pari nëpër këshilla, meqë sot e kemi në rend dite miratimin e këshillave, po edhe Strategjia e Informimit Publik...Sot, ose nesër në mëngjes ti aprovojmë, sepse duhet urgjent ta dërgojmë kërkesën për buxhet në Qeveri...

Pra, vazhdojmë pa pikën dy...Kush është për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2.Vendim për shpalljen e konkursit për pozitën e lira në Sekretariat të KQZ-së

Valdete Daka: I kemi pozitën e lira, i kemi marrë edhe përshkrimet...Ashtu si edhe draft vendimet...! E hapi diskutimin, pra siç e dini, që një kohë të gjatë e kemi të hapur pozitën e Zëvendës kryeshefit". Kjo pozitë, nuk është shpallur asnjëherë. Ne, kemi buxhet për këtë pozitë...E po ashtu, edhe për pozitën e drejtorit të ZRPP-së.

Adnan Rrustemi: Faleminderit. Përshëndetje. Sekretariati i ka sjellë materialet, kushtet që i parasheh rregullorja, por edhe detyrat dhe përgjegjësitë...Në të njëjtën kohë, janë bërë veçimet për dy pozitën: për Zëvendës kryeshefin dhe drejtorin e ZRPP-së...Si të them, për nevojën operacionale unë jam dakord ta shqyrtojmë dhe ta miratojmë vendimin për shpalljen e këtyre dy pozitave. Të ndiqen procedurat në këtë drejtim, dhe pastaj, të bëjmë debat edhe për pozitën në Sekretariat që, nuk janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e KQZ-së ashtu siç janë dy pozitën e para, mirëpo ne të debatojmë dhe, si të them ta urdhërojmë Sekretariatin që ti shpallë dhe ti realizoj edhe pozitën e tjera...

Të përmirësohet një gabim teknik në vendim, dhe po ashtu, kërkoj që të ftohet Ambasada Britanike që në kuadër të Memorandumit me institucionet e vendit, të mbikëqyrë konkursin tonë...! Pra, e dimë që ky memorandum edhe ka dështuar me institucionet tjera, mirëpo së paku në KQZ të ta monitoroj këtë proces...Kryetarja, le ti ftojë madje, edhe organizatat civile që ta monitorojnë këtë proces...

Jam dakord që këto dy konkurse, të shpallen sa më shpjet që është e mundur!

Valdete Daka: Tashmë, unë jam e kontaktuar nga ambasada britanike dhe të jenë të përfshirë në zgjedhjen e këtyre dy pozitave të larta. Me lejen e KQZ-së, unë edhe zyrtarisht do ti ftoj që të përfshihen në përzgjedhjen e këtyre dy pozitave të larta...Po ashtu, meqë tashmë katër muaj nuk kemi drejtues të ZRPP-së dhe jemi në proces zgjedhor, kishte me qenë mirë të ushtrijmë një ushtrues detyre deri në përzgjedhjen e drejtorit të kësaj zyre...

Adnan Rrustemi: Ta miratojmë vendimin njëherë, dhe ose të na sillen në rend dite, ose ta fusim në rend dite cështjen e "u.d" të ZRPP-së...?

Sami Hamiti: Edhe unë jam plotësisht dakord që të shpallen këto dy vende të lira, por meqë jemi në proces zgjedhor, e besoj që brenda zyrës është një person, është Valmira dhe ajo le ta kryej detyrën si ushtruese, pra le ta kryej punën...

Adnan Rrustemi: Jam dakord, veç le të bëhet Draft vendimi...!

Valdete Daka: Po, le të futet si pikë e rendit të ditës...? Kush është për që, kjo të jetë si pikë e rendit të ditës së kësaj mbledhje...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë pikë të rendit të ditës: “Shqyrtimi dhe miratimi i ushtruesit të detyrës së Drejtorit të ZRPP-së”.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan vendimin për shpalljen e konkursit për Zëvendës Krye shëf të SKQZ-së, dhe miratuan vendimin që Valmira Selmani të caktohet ushtruese e drejtorit të ZRPP-së.

(Përgjatë diskutimit të çështjes rreth ZRPP-së, anëtarët e KQZ-së diskutuan që Zyra të përforcohet me zyrtarë në mënyrë që, procesi zgjedhor të mos ketë komplikime...)

Valdete Daka: Vazhdojmë me pjesën tjetër: me pozitat e lira në Sekretariat. Edhe këtu mendoj që duhet bërë një prerje: t’u jepet përparësi përzgjedhjes së kryesuesve të KKZ-ve, sepse bëhet fjalë për 6 pozita...Ndërsa sa u përket pozitave në ZRPP, s’ka asnjë dyshim që janë urgjente edhe këto...! Zyra, siq dihet funksionon vetëm me një person, e që tash ky person është u.d...

Kurse, për kryesuesit e KKZ-ve s’kemi çka presim, janë vakante...

Adnan Rrustemi: Po e japë mendimin tim: edhe dje kam kërkuar që konkurset të ndahen, në mënyrë që të dihet se ku është përgjegjësia e Komisionit, dhe ku fillon përgjegjësia e Sekretariatit. Në rastin e dy pozitave të para, përgjegjësia është vetëm e KQZ-së, dhe mirë që po e përmbushim...Në rastin e Sekretariatit, kemi përgjegjësi edhe të komisionit dhe, përgjegjësi të sekretariatit...Duhet patjetër që, pozitat të plotësohen...Si komision, nuk mund të marrim vendim...mirëpo, mund të urdhërojmë, kërkojmë, përcaktojmë qoftë edhe afate që Sekretariatit që ti fillojë procedurat për plotësimin e këtyre vendeve...Neni 66.7 i Ligjit për Zgjedhjet thotë që, “Stafi i Sekretariatit përzgjidhet dhe punësohet nga Krye shëfi Ekzekutiv i SKQZ-së në pajtim me procedurat e Qeverisë së Kosovës”.

Natyrisht, ne nuk mund të marrim vendim por jam dakord që ta gjejmë një gjuhë, një konkluzion të përbashkët...

Sami Hamiti: Ne, s’kemi të drejtë me marrë vendim, mirëpo një qëndrim për këto pozita e kam qysh nga dhjetori i vitit 2017 ! Tash, jemi në vitin 2019. Edhe krye shëfi, duhet me i dhënë dikujt përgjegjësi, por normalisht, ai nuk i ka zbatuar kërkesat tona...Ne po marrim qëndrime, sa herë kemi marrë qëndrime por, ai se ka marrë asnjë vendim...Edhe ai, i jep llogari dikujt...Unë s’po kërkoj afat, mirëpo ai duhet të obligohet, sepse ai i jep llogari dikujt...

Specifikat janë, çdo gjë është e kryer, pra duhet të obligohet...pra, ti jepet një afat...

Adnan Rrustemi: Janë edhe do pozita të brendshme si ushtrues detyre, e që duhet të kryhen, të përmbillen...

Ercan Spat: Jam dakord që këto vende duhet sa më shpejtë të plotësohen. Mirëpo, as formalisht nuk votoj që të shpallen, është përgjegjës personi i caktuar...

Valdete Daka: Ne si shpallim, mirëpo mund ta obligojmë...

Florian Dushi: Unë mendoj që nga pozicioni ynë, mund të kemi dilema procedurale, mirëpo këto në asnjë rast nuk mund të jenë pengesë apo nuk mund të jenë të natyrës që do të na bënin të hezitojmë që me

kërku nga Sekretariati dhe me afatizuar këtë kërkesë që me u shpallë sa ma parë këto konkurse...Ne si KQZ, pavarësisht ndarjes administrative të brendshme, ne s'mund t'i lëmë KKZ-të pa kryesues, ZRPP-në pa zyrtar...Nuk bëjmë asnjë lloj shkelje ligjore nëse kërkojmë – urdhërojmë që sa më parë, të implementohen konkurset...

Adnan Rrustemi: Këtu kemi edhe procesmbajtës, dhe ne duhet të pajtohemi këtu që konkurset të shpallen, të vlerësohen procedurat, dhe të mos humbet kohë...Nuk marrim vendime, por le të fillojnë procedurat...Ne duhet t'i përmbylim këto punë, ta ndjekim çdo javë procesin...! Ne, në anën tjetër, po e shmangim çështjen e Kryeshefit, nuk po dua ta bëjë temë sot, por duhet ta kemi edhe një vendim për Kryeshefin dhe, menjëherë të fillojnë procedurat...

Miradije Meha: Procedurat janë, por duhet të bëhet kërkesa nga njësia kërkuese, dhe pa e pasur kryeshefin ne s'mund të bëjmë asnjë hap në këtë drejtim...

Valdete Daka: Këto procedura, janë moti të kryera, sa herë duhet të bëjmë procedura...Janë shpallë procedurat, janë anuluar, pastaj janë marrë lejet nga ministritë, janë bërë përshkrimet, dhe prapë nuk janë zbatue...Kjo ka ndodhë disa herë...Unë po pyes: sa herë ne duhet të kërkojmë...?

Florian Dushi: Drejtoreshën mundem me e mirëkuptua, por ky institucion as edhe një orë nuk duhet të jetë pa Krye shef... Jemi edhe në pritje të përgjigjes nga një institucion....Por, ende s'kemi përgjigje, por institucioni as edhe një orë nuk guxon të mbetet pa krye shef...Por, çështja është teknike, dhe ne duhet ta caktojmë një "u.d.", qoftë edhe deri në fund të ditës...! Unë, po flas nga përvoja ime...E ne, jemi qe një javë pa krye shef...Ne, duhet t'i japim udhë kësaj çështje...

Adnen Rrustemi: Tema po e hap temën...! Po, nuk është në rregull që Sekretariati është pa krye shef dhe madje, s'ka as ushtrues detyre...! Kam kërkuar që të na sillen kjo në rend dite...Ndoshta dallojmë në pikëpamje të ndryshme, por mendoj që madje, vetë KRPP është në gjendje jo funksionale...Por, ne sa më shpjet duhet ta pastrojmë situatën sepse, ose duhet t'ia vazhdojmë kontratën krye shefit, ose ta caktojmë një ushtrues detyre...Pra, mos ta zgjasim më tutje, vetëm ta kemi si rend dite...

Florian Dushi: E kam të qartë çka po ndodh, dhe e kam të qartë edhe rolin e krye shefit...Le të hiqen dilemat: është kjo punë teknike, sepse pavarësisht cilës do arsye, në këtë institucion duhet të mos ndalet puna sepse, jemi në proces zgjedhor...

Adnan Rrustemi: Si komision, mendoj që zyrtarisht duhet ta kemi një njoftim që Krye shefit i ka dalë mandati, dhe menjëherë qysh nesër le të na sillen të gjitha materialet, dhe të marrim një vendim për këtë çështje...

Valdete Daka: Nëse pajtoheni, nesër ta kemi këtë çështje në mbledhje...!

3.Përbërja e Këshillave të KQZ-së

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër. E keni draftin përpara, secili ku është i vendosur...! Nëse keni diçka, ndonjë vërejtje etj. ?_Atëherë, kush është për këtë përbërje të anëtarëve të Këshillave të KQZ-së...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan përbërjen e re të këshillave të KQZ-së, si vijon:

a. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë përbëhet nga anëtarët :

- 1.Valdete Daka, kryesues
- 2.Ercan Spat ,zëvendës kryesues
- 3.Nazlie Bala, anëtar
- 4.Sami Hamiti, anëtar,
- 5.(PAN), anëtar

b. Këshilli për Personel përbëhet nga anëtarët:

- 1.Stevan Veselinoviq, kryesues
- 2.Florian Dushi, zëvendës kryesues
- 3.(PAN), anëtar
- 4.Adnan Rrustemi, anëtar
- 5.Alfred Kinolli, anëtar

c. Këshilli për Buxhet dhe Financa përbëhet nga anëtarët:

- 1.PAN, kryesues
- 2.Nazlie Bala, zëvendës kryesues
- 3.Sami Hamiti, anëtar
- 4.Alfred Kinolli, anëtar
- 5.Ercan Spat, anëtar

d. Këshilli për Çështje Ligjore përbëhet nga anëtarët:

- 1.Florian Dushi, kryesues

2. Adnan Rrustemi, zëvendës kryesues
3. Cemajl Kurtis, anëtar
4. PAN, anëtar
5. Alfred Kinolli, anëtar

e. Këshilli për Operacione zgjedhore përbëhet nga anëtarët:

1. Adnan Rrustemi, kryesues
2. PAN, zëvendës kryesues
3. Florian Dushi, anëtar
4. Ercan Spat, anëtar
5. Stevan Veselinoviq, anëtar

3. Plotësimi dhe Ndryshimi i Vendimit për Zgjatjen e Orarit të Punës

Valdete Daka: E kemi marrë në fillim një vendim për zgjatjen e orarit të punës. Mirëpo, sa u përketë kryesuesve të KKZ-vë, orari zgjatet vetëm në katër komunitat ku janë zgjedhjet...Pra, ka një ndryshim – plotësim. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit për Zgjatjen e Orarit të Punës

4. Të ndryshme.